



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

DREJTORIA E ZBATIMIT TË POLITIKAVE DHE ADMINISTRIMIT TË NDIHMËS
PARËSORE

SEKTORI I ADMINISTRIMIT TË OFRUESVE TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE

Nr. 97 prot.

Tiranë, më 09.01.2025

URDHËR

Nr. 11 datë 09 / 01 /2025

“PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS JANAR– DHJETOR 2025”

Në zbatim të detyrimeve të parashikuara në ligjin nr.111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij;

URDHËROJ:

1. Miratimin e Planit të Punës Janar – Dhjetor 2025, të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.
2. Ngarkohen punonjësit e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në këtë plan.
3. Ngarkohet Sektori i Protokollit për njoftimin e këtij urdhri.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Ergys Qirici



Rr. “Jordan Misja” Njësia Bashkiake nr. 9, Godina nr.3, Tiranë



DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS PLANI I PUNËS

JANAR-DHJETOR 2025

Plani i punës Janar-Dhjetor 2025, përmbledh detyrimet funksionale dhe obligimet që rrjedhin nga Ligji Nr. 111/2017, politikat dhe prioritetet e përcaktuara nga Ministri i Drejtësisë, dokumentat strategjikë në të cilat DNJF është e përfshirë si dhe rekomandimet e lëna nga KLSH gjatë ushtrimit të kontrollit me temë: *“Ndihma Juridike e Garantuar nga Shteti”*.

Plani i punës Janar-Dhjetor 2025, është plani i gjashtë i miratuar që nga fillimi i funksionimit të DNJF. Ky dokument është kontribut dhe ka për objekt veprimtarinë e të 3 (tre) Drejtorive përbërëse të DNJF. Ky plan është një dokument pune i cili shërben si udhëheqës në realizimin e objektivave institucionale përmes përcatimit të masave dhe aktiviteteve konkrete.

Plani i punës Janar-Dhjetor 2025, përmbledh detyrimet funksionale, përpilimin dhe zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ligji *“Zbatimin e Sistemit Buxhetor në RSH”*, duke synuar zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, strukturën, parimet dhe bazat e procesit buxhetor, marrëdhëniet financiare si dhe përgjegjësitë për zbatimin e legjislacionit buxhetor në tërësi.

Plani i punës Janar-Dhjetor 2025, parashikon **11 objektiva të strukturuar** si vijon:

1. Garantimi i funksionimit të sistemit të ndihmës juridike parësore;
2. Garantimi i funksionimit të sistemit të ndihmës juridike dytësore;
3. Monitorimi i shërbimit të ndihmës juridike parësore/dytësore;
4. Ndërveprimi me donatorët dhe institucionet e përfshira në sistemin e ndihmës juridike falas në drejtim të krijimit të databazës elektronike mbi rastet e ndihmës juridike parësore dhe platformës mbi ndihmën ligjore falas online;
5. Dhënia e kontributit të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas në kuadër të dokumentave strategjike dhe procesit të integritetit evropian;
6. Informimi dhe promovimi mbi sistemin e ndihmës juridike;
7. Raportime mbi sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti;
8. Menaxhimi dhe planifikimi financiar i sistemit të ndihmës juridike;
9. Rialokimi dhe detajimi i fondeve të buxhetit vjetor;
10. Mirëadministrimi i Burimeve Njerëzore në funksion të strukturës së re të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas për vitin 2025 dhe Prokurimi i fondeve publike;
11. Hartimi i raporteve financiare, analiza financiare si dhe raportime në kuadër të granteve/projekteve në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare.

OBJEKTIVI I: GARANTIMI I FUNKSIONIMIT TË SISTEMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE

Nr.	Masat/proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/Dr. Përgjegjëse	Afate / komente
1.1	Lidhja e marrëveshjes së re të bashkëpunimit midis Ministrisë së Drejtësisë dhe UNDP	Ndërmarrja e procedurave në kuadër të lidhjes së marrëveshjes së re të bashkëpunimit në kuadër të krijimit të 2 platformave mbështetëse për DNJF: -Databaza elektronike mbi rastet e trajtuara nga qendrat -Platforma mbi ndihmën ligjore falas online	Drejtoria e Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndihmës Parësore. Drejtoria e Financës, Arkivit dhe Shërbimeve Mbështetëse	Në varësi të dakordësisë së donatorit.
1.2	Administrimi i qendrave aktuale të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore	Mbarëvajtja e veprimtarisë së qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore përmes: - Komunikimit ditor me punonjësit e qendrave; - Administrimit të të dhënave të shërbimit të ofruar; - Adresimit dhe përcjelljes së çdo problematike të punonjësve të qendrave; - Zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta në kuadër të promovimit të qendrave; - Mirëfunksionimit të qendrave përmes pajisjeve me mjetet e nevojshme logjistike. - Bashkëpunimit me institucionet e pushtetit qendror/vendor me qëllim marrjen e masave që masat që Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore të ofrojnë të gjitha facilitetet e nevojshme, në përputhje me standardet e miratuara (<i>akses nga personat me aftësi të kufizuara, mundësimi i ambienteve private për çëshjet konfidenciale etij.</i>)	Drejtoria e Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndihmës Parësore.	Janar-Dhjetor 2025

		Vlerësimi i përfundimit të QSHNJP në baza 6 mujore sipas indikatorëve të përcaktuar në urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm.		Janar-Dhjetor 2025
1.3	Kalimi nën administrim të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas të qendrave të hapura me mbështetjen e UNDP, pas përfundimit të marrëveshjes në Dhjetor 2024.	Miratimi i urdhrave për kalimin me buxhet shteti të 6 QSHNJP të mbështetura nga UNDP, pas miratimit të strukturës së re të DNJF ku është parashikuar kalimi i tyre me buxhet shteti. Fillimi i marrëdhënieve financiare për 6 punonjësit me trajnim të posaçëm të Qendrave Lezhë, Pogradec, Korçë, Dibër, Elbasan dhe Kukës.	Drejtoria e Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndhmës Parësore Drejtoria e Financës, Arkivit dhe Shërbimeve Mbështetëse Ministria e Drejtësisë	Janar-Dhjetor 2025
1.4	Forcimi i kapaciteteve të punonjësve të QSHNJP nëpërmjet zhvillimit të trajnimeve fillestare dhe vazhduese.	Administrimi i nevojave për trajnime vazhduese të përcjella nga punonjësit e Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore dhe përfshirja e tyre në programin e planifikimit të trajnimeve vazhduese. Shkresë DAP/ASPA me lëndë: Kërkesë për bashkëpunim për miratimin e programit të planifikimit të trajnimeve vazhduese për vitin 2024, si dhe zhvillimin e trajnimeve, si detyrim ligjor i përcaktuar në nenin 9 shkronja “g” të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”. Shkresë Organizatave Ndërkombëtare Mbështetëse me lëndë: Kërkesë për mbështetje për rritjen e kapaciteteve dhe aftësimin profesional të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore. Zhvillimi i trajnimeve vazhduese nga ASPA/Organizatave Ndërkombëtare Mbështetëse në rast dakordësie të kërkesës për mbështetje.	Drejtoria e Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndhmës Parësore. Drejtoria e Financës, Arkivit dhe Shërbimeve Mbështetëse Shkolla Shqiptare e Administratës Publike	Janar-Dhjetor 2025
1.5	Hapja e thirrjes për financimin e organizatave jofitimprurëse të	- Shkresë Ministrisë së Drejtësisë me qëllim dakordësinë mbi afatin e hapjes së thirrjes për financimin e	Drejtoria e Zbatimit të Politikave dhe	Janar-Prill 2025

	autorizuara nga Ministri i Drejtësisë pas përfundimit të projekteve në proces.	organizatave jofitimprurëse të autorizuara. - Hartimi i Planit Vjetor të Financimit dhe publikimi i tij në faqen zyrtare të MD/DNJF - Hapja e thirrjes për financim sipas përcaktimeve të VKM nr. 55/2019. - Marrja pjesë në komisionin e vlerësimit dhe ankimit për financimin e OJF-ve - Ndërmarrja e procedurave për lidhjen e kontratave me Organizatat e shpallura fituese	Administrimit të Ndhmës Parësore. Drejtoria e Financave, Arkivit dhe Shërbimeve Mbështetëse	
1.6	Ofrimi i ndihmës juridike parësore nga Klinikat e Ligjit	Ndërveprimi aktiv mes DNJF dhe Klinikave të Ligjit me të cilat kemi lidhur marrëveshje bashkëpunimit përmes: - Trajnimit mbi ndihmën juridike për studentët e angazhuar pranë Klinikave të Ligjit; - Praktikave të punës për studentët e angazhuar pranë Klinikave të Ligjit; - Zhvillimit të aktiviteve të përbashkëta ndërgjegjësuere/informuese	Drejtoria e Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndhmës Parësore.	Mars 2025
1.7	Administrimi i plotë i të dhënave mbi shërbimin e ndihmës juridike parësore.	- Mbledhja dhe sistematizimi i të dhënave mbi ndihmën juridike parësore; - Plotësimi i regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve për ndihmën juridike parësore - Hartimi dhe publikimi në faqen zyrtare të analizës statistikore mbi ndihmën juridike parësore (analizë që hartohet çdo muaj)	Drejtoria e Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndhmës Parësore.	Janar-Dhjetor 2025

OBJEKTIVI 2: GARANTIMI I FUNKSIONIMIT TË SISTEMIT TË NDIHMËS JURIDIKE DYTËSORE

Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/Dr. Përgjegjës	Afate / komente
2.1	Rishikimi i akteve nënligjore në fushën e ndihmës juridike dytësore me qëllim përmirësimin e procedurave dhe dhënien e shërbimit për qytetarët.	- Draftimi i akteve nënligjore; - Miratimi dhe hyrja në fuqi e tyre	Drejtoria e Mbikëqyrjes dhe Administrimit të Ndihmës Dytësore	Janar-Mars 2025
2.2	Sigurimi i shërbimit të avokatëve	- Lidhja e kontratës me avokatët për vitin 2025 si dhe publikimi i listës	Drejtoria e Mbikëqyrjes dhe Administrimit të Ndihmës Dytësore	Janar- Mars 2025
2.3	Administrimi i të dhënave mbi shërbimin e ndihmës juridike dytësore	- Mbledhja dhe sistematizimi i të dhënave mbi numrin e vendimeve gjyqësore me objekt ndihmën juridike dytësore; - Plotësimi i regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve për ndihmën juridike dytësore për përjashtimin nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore; - Hartimi dhe publikimi në faqen zyrtare të analizës statistikore mbi ndihmën juridike dytësore (analizë që hartohet çdo muaj)	Drejtoria e Mbikëqyrjes	Janar- Dhjetor 2025
2.4	Ndjekja e vendimeve gjyqësore me objekt përfitimin e ndihmës juridike dytësore	- Komunikimi me Dhomat Vendore të Avokatisë në kuadër të caktimit të avokatit që do të ofrojë shërbimin e ndihmës juridike dytësore; - Ankimimi i vendimeve gjyqësore me objekt përfitimin e ndihmës juridike dytësore dhe/ose përjashtim nga shpenzimet / tarifat gjyqësore referuar nenit 22 pika 9 e Ligjit 111/2017 <i>"Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas mund të ankimojë vendimin e gjykatës për pranimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore, nëse pretendon se kjo kërkesë është dukshëm abuzive ose</i>	Drejtoria e Mbikëqyrjes	Janar- Dhjetor 2025

haptazi e pabazuar. Në këtë rast zbatohen afatet dhe rregullat për ankimin e vendimeve përfundimtare, sipas dispozitave të legjislacionit procedural. Kundër vendimit të gjykatës së apelit nuk lejohet rekurs në Gjykatë të Lartë”.

OBJEKTIVI 3: MONITORIMI I SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE/DYTËSORE

Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/Dr. Përgjegjës	Afate / komente
3.1	Monitorimi i shërbimit të ofruar nga Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore	Hartimi dhe miratimi i kalendarit të monitorimeve Kryerja e monitorimeve tremujore për qendrat e ndihmës juridike parësore	Drejtoria e Mbikëqyrjes dhe Administrimit të Ndihmës Dytësore	Janar-Dhjetor 2025
		Hartimi i raporteve të monitorimit / Vlerësimi i performancës		Janar-Dhjetor 2025
3.2	Monitorimi i shërbimit të ofruar nga Organizatat Jofitimprurëse të Autorizuara të cilat përfitojnë financim nga buxheti i shtetit	Hartimi dhe miratimi i kalendarit të monitorimeve	Drejtoria e Mbikëqyrjes dhe Administrimit të Ndihmës Dytësore	Majr-Dhjetor 2025
		Kryerja e monitorimeve katër mujore për organizatat		
		Hartimi i raporteve të monitorimit / Vlerësimi i performancës		
3.3	Monitorimi i shërbimit të ofruar nga Avokatët e ndihmës juridike dytësore	Hartimi dhe miratimi i kalendarit të monitorimeve Kryerja e monitorimit fillestar për avokatët e rinj të ndihmës juridike dytësore Kryerja e monitorimit të vazhdueshëm për çdo avokat të ndihmës juridike dytësore	Drejtoria e Mbikëqyrjes dhe Administrimit të Ndihmës Dytësore	Janar-Dhjetor 2025

		Hartimi i raporteve të monitorimit/Vlerësimi i performancës Hartimi i raporteve të mbikëqyrjes dhe përcjellja e rekomandimeve përkatëse		
3.4	Hartimi i raporteve përmbledhëse të monitorimit	Raport përmbledhës monitorimi për shërbimin e ndihmës juridike parësore; Raport përmbledhës monitorimi për shërbimin e ndihmës juridike dytësore.	Drejtoria e Mbikëqyrjes dhe Administrimit të Ndihmës Dytësore	Janar-Dhjetor 2025
3.5	Kryerja e pagesave për ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike	Verifikimi i dokumentacionit sipas raportit të monitorimit Fatura tatimore	Drejtoria e Financës	Janar-Dhjetor 2025

OBJEKTIVI 4: NDËRVEPRIMI ME DONATORËT DHE INSTITUCIONET E PËRFSHIRA NË SISTEMIN E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/Dr. Përgjegjës	Afate / komente
4.1	Ndërveprimi me UNDP në kuadër të projekteve të përbashkëta	Ndjekja e procedurës së krijimit dhe funksionimit të: Databazës elektronike Platformës mbi ndihmën ligjore falas online	Drejtoria e Zbatimit të Politikave	Janar - Dhjetor 2025 <i>Në varësi të kohëzgjatjes së projekteve donatorët</i>
4.2	Ndjekja e proceseve të punës me donatorë të ndryshëm si UNDP, OSCE, Agjencia Franceze për Zhvillim, JUSTAL etj.	- Evidentimi i nevojave për mbështetje; - Zhvillimi i takimeve në kuadër të bashkëpunimit; - Ndërmarrja e procedurave të bashkëpunimit në rast dakordësie	DNJF UNDP OSCE Agjencia Franceze për Zhvillim JUSTAL	Janar - Dhjetor 2025 <i>Në varësi të projekteve donatorët</i>

OBJEKTIVI 5: DHËNIA E KONTRIBUTIT DHE RAPORTIMI I DNJF NË KUADËR TË PROCESIT TË INTEGRIMIT EVROPIAN/STRATEGJIVE

Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/Dr. Përgjegjës	Afate / komente
-----	---------------------------------	----------------------------------	-----------------------------	-----------------

5.1	Raportime në kuadër të procesit të Integritetit Evropian dhe Konventave Ndërkombëtare/Strategjive	- Angazhim i DNJF në kuadër të Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut (SELP). - Angazhim i DNJF në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë (SND) - Angazhim i DNJF në kuadër të Strategjisë së Drejtësisë për të Miturit (SDM) - Kontribut i DNJF në kuadër të angazhimit në Planin e Veprimit për Partneritet dhe Qeverisje të Hapur (OGP) - Angazhimin i DNJF në kuadër të procesit të Integritetit Evropian dhe Raportimeve Ndërkombëtare - Kontribut në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Para-anëtarësimit IPA. - Kontributi i DNJF në CEPEJ “Dashboard Eastern Balkans; - Kontribut i DNJF në kuadër të raportimit të Kapitullit 23. - Kontribut në kuadër të monitorimit të zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave ; - Kontribut i DNJF për Planin Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrje të Romëve dhe Egjiptianëve - Kontribut në Strategjinë ndërsektoriale për mbrojtjen e viktimave të krimit për periudhën 2024-2030; - Kontribut sa i përket Nënkomitetit Bashkimi Evropian–Shqipëri “Drejtësia, Liria dhe Siguria”. - Kontribut i DNJF në kuadër të raportimit mbi kontributin e parë final për kapitullin 23 dhe Institucionet demokratike;	Drejtoria e Zbatimit të Politikave	Janar-Dhjetor 2025
-----	--	---	------------------------------------	--------------------

- Kontribut i DNJF në kuadër të raportimit mbi draftin e Pozicionit Negociues, në kuadër të procesit të hartimit të udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës;
- Kontribut i DNJF në kuadër të raportimit për Konventën e Këshillit të Evropës mbi Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunën në Familje (Konventa e Stambollit);
- Kontribut i DNJF në kuadër të raportimit mbi draftin e Pozicionit Negociues, të Kapitullit 24, në kuadër të Bashkëpunimit Gjyqësor për çështje civile dhe penale;
- Kontribut i DNJF, në kuadër të Agjendës 2030 dhe objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm;
- Kontribut i DNJF në kuadër të Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (KDKPAK);
- Kontribut i DNJF në kuadër të SASPAC për raportimin e projekteve me financim të huaj.

OBJEKTIVI 6: PROMOVIMI I SISTEMIT TË NDIHMËS JURIDIKE

Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/Dr. Përgjegjës	Afate / komente
6.1	Përgatitja dhe ndjekja e publikimeve të DNJF në faqen zyrtare dhe në rrjetet sociale të Facebook, instagram	Ndjekje e procedurave të nevojshme me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve.	DNJF	Janar-Dhjetor 2025
6.2	Përditësimi i faqes ëeb të DNJF	Përditësimi dhe publikimi i të dhënave më të fundit sipas rubrikave të mirëpërcaktuara.	DNJF	Janar-Dhjetor 2025
6.3	Zhvillimi i takimeve promovuese/sensibilizuese/ edukimit ligjor të publikut	- Hartimi i një analize me qëllim forcimin dhe maksimizimin e impaktit në ndërgjegjësimin e publikut mbi sistemin e ndihmës juridike ku të përcaktohen komponentët ku duhet të zbatohet Drejtoria e Zbatimit të Politikave	DNJF Ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore	Janar 2025

		dhe Administrimit të Ndhmës Juridike Parësore në konceptimin e Kalendarit Vjetor të Aktiviteteve; - Hartimi i Kalendarit të Aktiviteteve për vitin 2025, duke u bazuar në komponentët dhe gjetjet e analizës - Zhvillimi i fushatave të ndërgjegjësimit dhe sesioneve të edukimit ligjor		Janar 2025 Janar – Dhjetor 2025
--	--	---	--	---

OBJEKTIVI 7: RAPORTIME MBI SISTEMIN E NDIHMËS JURIDIKE TË GARANTUAR NGA SHETI

Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/Dr. Përgjegjës	Afate / komente
7.1	Përgatitja e raportimeve drejtuar Ministrit të Drejtësisë mbi sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti¹	- Hartimi i raportimeve mujore; 3 mujore; 6 mujore dhe vjetore drejtuar Ministrit të Drejtësisë; - Hartimi i raportimeve të tjera drejtuar Ministrit të Drejtësisë në varësi të kërkesave	DNJF	Janar-Dhjetor 2025
7.2	Trajtimi i shkresave nga institucione të ndryshme në kuadër të raportimit mbi ecurinë dhe progresin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti	Dhënia e informacionit mbi ecurinë dhe zhvillimet e sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti lidhur me kërkesat për informacion	DNJF	Janar-Dhjetor 2025

OBJEKTIVI 8: MENAXHIMI DHE PLANIFIKIMI FINANCIAR I SISTEMIT TË NDIHMËS JURIDIKE

Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/Dr. Përgjegjës	Afate / komente
8.1	Vlerësimi i kostove dhe planifikimi i shpenzimeve të lidhura me dhënien e ndihmës juridike	Ndjekja, analizimi dhe planifikimi i shpenzimeve financiare mbi sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti.	Dr. Financave	Janar 2025
8.2	Menaxhimi i fondeve buxhetore për dhënien e ndihmës juridike	Menaxhimi i fondeve buxhetore të DNJF dhe hartimi i raportimeve financiare	Dr. Financave	Janar-Dhjetor 2025

¹ Sipas përcaktimeve të Ligjit nr.111/2017.

OBJEKTIVI 9 : RIALOKIMI DHE DETAJIMIN I FONDEVE TË BUXHETIT VJETOR RAPORTIME

Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/Dr. Përgjegjës	Afate / komente
9.1	Detajimi i fondeve të Buxhetit për vitin 2025	Rialokimi i fondeve të papërdorura me financim nga donatorët sipas strukturave buxhetore si dhe sipas nevojave të institucionit Pasqyrimi në regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike dhe shpallja në faqen zyrtare të APP dhe Institucionit të ndryshimeve Realizimi i likuidimit të detyrimeve të prapambetura me prioritet	Drejtoria e Financës Komisioni i Prokurimit Drejtoria e Financës	Janar 2025 Janar 2025 Janar - Dhjetor 2025

HARTIMI I PAGESAVE TË PUNONJËSVE TË DNJF NGA STRUKTURAT E BUXHETIT TË SHTETIT DHE NGA ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE

Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/Dr. Përgjegjës	Afate / komente
9.2	Hartimi i dokumentacionit financiar, për pagat sigurimet dhe shpenzimet	Hartimi i pagesave të pagave të punonjësve të NDJF si dhe punonjësit e qëndrave të sponsorizuar nga OJF Hartimi i Urdhër Shpenzimeve për shpenzimet financiare të artikujve 600 dhe 601 Deklarimi i sigurimeve shoqërore shëndetsore dhe tatimit mbi të ardhurat Pasqyrimi në sistemin HRMIS të pagave të punonjësve Hartimi i listëprezencës së punonjësve	Drejtoria e Financës	Janar-Dhjetor 2025
9.3	Urdhër Pagesat	Gjenerimi nga sistemi HRMIS i Urdhër Shpenzimeve Transferrat bankare sipas Bankave të nivelit të dytë Pasqyrimi i shtesave, ndalesave apo cdo vendim gjyqësor	Drejtoria e Financës	Janar - Dhjetor 2025

Sistemi AFMIS, paraqitja e dokumentacionit justifikues të shpenzimit dhe ngarkimi në sistem

OBJEKTIVI 10: MIRËADMINISTRIMI I BURIMEVE NJERËZORE DHE REKRUTIMI I PUNONJËSVE SIPAS STRUKTURËS SË RE TË DNJF TË MIRATUAR PËR VITIN 2025

Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/Dr. Përgjegjës	Afate / komente
10.1	Miratimi i numrit të Punonjësve për vitin 2025		Ministria e Drejtësisë	Janar 2025
10.2	Evidentimi i nevojave për kualifikimin e punonjësve	Evidentimi i kualifikimeve të punonjësve Hartimi i planit vjetor të zhvillimit profesional të BNJ	Drejtoria e Financës ASPA	Janar 2025
10.3	Vendet vakante	Evidentimi dhe raportimi i vendeve vakante në zbatim të strukturës së miratuar për institucionin Shpallja e vendeve vakante në Sistemin HRMIS për punonjësit me Status të Nëpunësit Civil Percaktimi i përshkrimit të punës dhe percaktimi i kriterëve për kualifikim në procedurën e rekrutimit të punonjësve Shpallja në faqen Zyrtare të DNJF për vendet vakante, Ngritja e Grupit të punës për pranimin ose skualifikimin e kandidatëve	DAP Drejtoria e Financës Burimet Njerëzore	Janar-Dhjetor 2025

OBJEKTIVI 11: HARTIMI I RAPORTEVE FINANCIARE DHE ANALIZA E BUXHETIT

Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/Dr. Përgjegjës	Afate / komente
11.1	Pasqyrat financiare për vitin 2024	Plotësimi i pasqyrave financiare për vitin 2024, sipas formatit standart të miratuar nga Ministria e Financës	Drejtoria e Financës	Mars 2025
11.2	Inventarët fizikë dhe kontabël	Kryerja e inventarëve fizik dhe kontabël për aktivet e institucionit	Drejtoria e Financës	Dhjetor 2025

11.3	Amortizimi i pajisjeve	Amortizimi i pajisjeve objekt inventari të DNJF-së Pasqyrimi i vlerave në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor paraardhës.	Drejtoria e Financës	Dhjetor 2025
-------------	-------------------------------	---	----------------------	--------------

HARTIMI I REGJISTRIT TE RISKUT, FORMULARET E VETËVLERËSIMIT SI DHE PLANI I VEPRIMIT PËR MENAXHIMIN FINANCIAR DHE KONTROLLIN

Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/Dr. Përgjegjës	Afate / komente
11.4	Hartimi i regjistrit te riskut	Ngritja e grupit te punës për hartimin e regjistrit të riskut	Grupi i punës Drejtoria e Financës	Janar 2025
11.5	Hartimi i formularit te vetëvlerësimit per institucionin	Hartimi i formularit te vetevlerësimit per periushen janar- Dhjetor dhe përcaktimi i performancës së institucionit	Drejtoria e Financës Grupi i punës	Janar 2025